

8388
22.04.2016



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. Regj. Them. 6960/2419/397
Dt. Regj. 09.09.2014

Nr. Vendimi 722
Dt. Vendimi 06.04.2016

V E N D I M
“Në emër të Republikës”

Gjykata Administrative e Apelit me trup gjykues te përbërë prej:

Kryesues:	Kastriot SELITA
Anëtare:	Rilinda SELIMI
Anëtare:	Altina NASUFI

me sekretare gjyqësore **Mimoza Lazri**, në Tiranë, sot më datë 06.04.2016 mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative nr. 6960/2419/397 akti, datë regjistrimi 09.09.2014 që u përket palëve ndërgjyqëse:

PADITËS:	Kombinati Mekanik Poliçan.
E PADITUR:	Drejtoria Rajonale Tatimore Fier.
OBJEKTI:	Anullimin teresisht te akteve administrative me Nr. 0002216, 0002217, 0002218, 0002219, 0002220 te dates 15.09.2012, per konfiskimin e mallrave prone e Kombinatit Mekanik Poliçan.
BAZA LIGJORE:	Neni 43, paragrafi i II i K.Pr.C., Udhezimi i Ministrit te Financave Nr. 24, dt. 02.09.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”, pika 109.8, germa A, paragrafi i dyte, neni 331, pika 3 i K.Pr.C.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin Nr. 6204 (2140) date 06.11.2012 ka vendosur:

1. *Pranimin e padise, se pales paditese “Kombinati Mekanik Poliçan” sh.p.k. Fier ndaj pales se paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, si padi e bazuar ne prova e ne ligj.*
2. *Anullimin teresisht te akteve administrative me Nr. 0002216, 0002217, 0002218, 0002219, 0002220 date 15.09.2012, te pales se paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, per konfiskimin e mallrave, prone e Kombinatit Mekanik Poliçan dhe kthimin e ketyre mallrave.*
3. *Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te pales se paditur.*

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit Vlore, pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier me të cilin ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrezimin e kerkese padise, për shkaqet:

- Ne date 15.09.2012 subjektit ne fjale i eshte ushtruar nje kontroll nga am Inspektoreve Hetimit Tatimor prane Drejtorise Rajonale Tatimore Fier, dhe per kete eshte mbajtur dhe Akt-Konstatimet me Nr 0306712, 0306713, 0306714, 0306715, 0306716 dt 15.09.2012, per tregetim te mallit pa fature tatimore, nga ku ne baze te ligjit me Nr

9920 dt 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqipërisë ndryshuar me ligjin me Nr 10209 dt 23.12.2009, ndryshuar me ligjin Nr. 10261, dt. 01.04.2010, ndryshuar me ligjin 10415, date 07.04.2011, neni 121 pika 1, ku thuhet: "1. Tatimpaguesi, qe mban ne ruajtje, perdor ose transporton mallra te pashoqeruara me dokumente tatimore, ne perputhje me dispozitat e ketij ligji, denohet me konfiskim te te gjithë sasise se mallit, qe mbahej ne ruajtje, perdorej apo transportohej, i pashoqeruar me dokumente tatimore", kane perpiluar procesverbalet e konfiskimit me Nr 0002216, 0002217, 0002218, 0002219, 0002220 dt 15.09.2012, ku me ane te te cilave eshte bere dhe konfiskimi i mallrave te cilat ishin pa fature tatimore.

- Sa me siper ne perpilimin e ketyre procesverbaleve te konfiskimit u bazua dhe ne ligjin me Nr. 7928, date 27.04.1995, "Per Tatimin mbi vleren e shtuar", i ndryshuar, neni 36, pika 1, ne te cilin citohet: "1. Personi i tatueshem qe kryen furnizimin, eshte i detyruar te leshoje per personin qe merr furnizimin nje fature ne lidhje me ate furnizim, perveç rasteve qe ne kete ligj percaktohet ndryshe. 1/1 Ne fund te fatures shenohet bleresi me emer, mbiemer, nenshkrim, transportuesi me emer, mbiemer, nenshkrim dhe shitesi me emer, mbiemer, nenshkrim dhe vule...", dhe ne baze te ligjit Nr 9920 dt 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin me Nr 10209 dt 23.12.2009, ndryshuar me ligjin Nr. 10261, dt. 01.04.2010, ndryshuar me ligjin Nr. 10415 date 07.04.2011, neni 121 pika 1, ne te cilin citohet: "1. Tatimpaguesi qe mban ne ruajtje, perdor ose transporton mallra te pashoqeruara me me dokumente tatimore, ne perputhje me dispozitat e ketij ligji, denohet me konfiskim te te gjithë sasise se mallit, qe mbahej ne ruajtje, perdorej apo transportohej, i pashoqeruar me dokumente tatimore".
- Gjithashtu ne nenin 51 te ligjit te sipercituar eshte e percaktuar se: "1. Shitesi leshon fature tatimore dhe bleresi duhet ta kerkoje ate ne kohen e realizimit te shitjes apo te kryerjes se punimit ose sherbimit. Fatura tatimore pergatitet nga shitesi ne jo me pak se dy kopje, nga te cilat njerën e merr dhe e ruan bleresi, kurse tjetren e mban dhe e ruan shitesi. Faturat pergatiten me numer rendor progresiv. 2. Tatimpaguesi, qe mban ne ruajtje, perdor apo transporton mallra te pashoqeruara me dokumente tatimore, denohet, ne perputhje me nenin 121 te ketij ligji".
- Ndersa persa i perket pretendimit te pales paditese se nuk e kishte faturen tatimore pasi nuk kishte peshore te madhe dhe te certifikuar nuk qendron pasi ky nuk eshte nje pretendim ligjor.
- Pra nisur nga sa theksuam me siper argumentuam se procesvebalet e gjobave me Nr 0002216, 0002217, 0002218, 0002219, 0002220 dt 15.09.2012 te perpiluar nga ana e Inspektoreve te Hetimit Tatimor prane Drejtorise Rajonale Tatimore Fier jane te bazuar ne ligje, kerkese padia e ngritur nga subjekti "Kombinati Mekanik Polican.
- Pra per sa theksuam argumentuam se vendimi i gjykates me Nr. 62-2012-6204 (2140) date 06.11.2012 eshte i pa bazuar dhe ne kundërshtim te hapur me ligjin.
- Per sa me siper kerkojme ndryshimin e ketij vendimi dhe rrezimin e padise.

Gjykata e Apelit Vlore, me vendimin Nr. 817-60-2014-1119 date 08.05.2014 ka vendosur: "Shpalljen e moskompetences lendore per shqyrtimin e ceshtjes civile me Nr. 2564 regjistri, date 26.12.2012 regjistrimi.
Dergimin e akteve gjykates kompetente, Gjykates se Apelit Administrativ Tirane".

Gjykata Administrative e Apelit;

Si u njoh me relatimin e **gjqtares Rilinda Selimi**, shqyrtoi aktet e dosjes dhe analizoi çështjen në tërësi;

V Ë R E N

Ankimi i palës së paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Berat nuk përmban arsye ligjore për cenimin e vendimit Nr. 62-2012-6204 (2140) date 06.11.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Ndryshe nga sa pretendon pala e paditur Kolegji cmon se vendimi objekt ankimi është marrë në përfundim të interpretimit të drejtë të ligjit material që lidhet me çështjen objekt shqyrtimi si dhe mbi një cilësim të drejtë të fakteve dhe rrethanave të shqyrtuara gjyqësisht. Si i tillë ai duhet të lihet në fuqi.

Nga aktet e gjykimit të çështjes në shkallë të parë rezultojnë këto fakte e rrethana;

Pala paditëse Kombinati Mekanik Polican është organizuar sipas Ligjit nr. 7582 datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore” në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Ushtrimi i aktivitetit të saj identifikohet me NIPT e tatimpaguesit regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat me nr. J 691024444 P.

Rezulton se pala paditëse ka nxjerre jashtë përdorimit makineri e pajisjen të destinuara si skrap për përdorim të mëtejshëm Shoqërisë “Kurum International” sh.a në bazë të kontratës dypalëshe lidhur pas përfundimit të procedurave të tenderimit.

Rezulton se me dt.15.09.2012 pala paditëse po kryente transportimin e materialeve skrap për në ambientet e firmës “Kurum International” Sh.a. Në vendin e quajtur, “Kryqezimi i Plugut”, në dalje të qytetit të Lushnjes, autokolonen prej pese makinash transporti, të cilat ishin ngarkuar me materialet e lartepërmendura, e ndalon për kontroll inspektorët e Sektorit të Zbatimit (Task Force) e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.

Inspektorët e hetimit tatimor kanë përpiluar akt-konstatimet me Nr 0306712, 0306713, 0306714, 0306715, 0306716 dt 15.09.2012 për transportim të mallit pa dokument/faturë tatimore dhe në bazë të tyre kanë përpiluar procesverbalet e konfiskimit të mallrave në mjetet e transportit me Nr 0002216, 0002217, 0002218, 0002219, 0002220 dt 15.09.2012.

Ky dënim administrativ është vendosur nga inspektorët në bazë të nenit 121, pika 1 e Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar sipas të cilit thuhet se:

“1.Tatimpaguesi, që mban në ruajtje, përdor ose transporton mallra të pashoqeruara me dokumente tatimore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, denohet me konfiskim të të gjithë sasisë së mallit, që mbahej në ruajtje, përdorej apo transportohej, i pashoqeruar me dokumente tatimore”

Duke mos qenë dakort me veprimet e palës së paditur për konfiskimin e mallrave, pala paditëse i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me kërkesë padinë objekt gjykimi për shfuqizimin e procesverbaleve të konfiskimit të mallrave me pretendimet se:

- Shoqeruesit e mallit të Kombinatit tone, u treguan Oficerëve të Policisë Tatimore, të D.R.T. Fier, faturen e shoqërimit të mallit, të cilën e kishim marrë me marreveshje me D.R.T. Berat, por ata thanë se kjo nuk ishte e vlefshme, për arsye se që të shoqerosh

mallin qe shitet, me kete dokument, nuk eshte e mjaftueshme, por duhet fatura tatimore e shitjes me t.v.sh.

- Kete “fature”, siç doli edhe gjate shqyrtimit gjyqesor te çeshtjes, ne e kishim me vete, por nuk kishim vendosur elementin “peshë e mallit”, te cilen do ta plotesonim, ne momentin e peshimit ne vendin e dorezimit te mallit, ashtu siç eshte parashikuar edhe ne kontraten dypaleshe, midis K.M.Poliçan dhe “Kurum International“ Sh.a.
- Po punonjesit e Policise Tatimore, te permendura me siper, nuk i moren parasysh pretendimet tona, dhe vazhduan punen e tyre me perpilimin e Akt - Kontrollit, e me pas te proces-verbalit te konfiskimit, te te gjithë sasise se mallit qe ndodhej ne pese kamionat e kolones.
- Oficeret e Policise Tatimore, te D.R.T. Fier, bene edhe verifikimin e peshes se mallit, duke e peshuar kete mall, ne subjektin privat te licensuar, zoti Y. Bekaj ne Lushnje, nga ku doli se nuk kishte diferenca, ne krahasim me Flete-Peshoret e mallit qe ishin marre ne peshoren e Doganes se Beratit.
- nuk vërtetohet asnjë rrethanë për qëllimin e palës paditëse për shmangien ndaj detyrimeve tatimore.

Gjykimi është zhvilluar në prani të palës së paditur si dhe janë marrë spjegimet nga inspektorët e hetimit që kanë ushtruar kontrollin. Gjithashtu rezultoi t'i jenë komunikuar aktet Avokaturës së Shtetit Zyra Vendore Vlorë e cila ka deklaruar mospjesëmarrjen me arsyetimin se aksionet e palës paditëse zotërohen 100 % nga Ministria e Mbrojtjes titullari i të cilës është aksioner i vetëm i saj.

Në përfundim të gjykimit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin nr. 6204 (2140) date 06.11.2012 ka çmuar të pambështetur në ligj konfiskimin e mallrave në transportim nga pala paditëse, vlerësim të cilin Kolegji Administrativ i Apelit e cmon në përputhje me ligjin dhe provat e administruar në gjykim.

Sipas pales se paditur parashtrohet edhe ne ankim se ne baze te nenit 51 të ligjit Nr 9920 dt 19.05.2008 “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqipërisë” i ndryshuar përcaktohet se: *“1. Shitesi leshon fature tatimore dhe bleresi duhet ta kerkoje ate **ne kohen e realizimit te shitjes** apo te kryerjes se punimit ose sherbimit. Fatura tatimore pergatitet nga shitesi ne jo me pak se dy kopje, nga te cilat njerën e merr dhe e ruan bleresi, kurse tjetren e mban dhe e ruan shitesi. Faturat pergatiten me numer rendor progresiv.*

2. Tatimpaguesi, qe mban ne ruajtje, perdor apo transporton mallra te pashoqeruara me dokumente tatimore, denohet, ne perputhje me nenin 121 te ketij ligji”.

Po ashtu, citon pala e paditur vendimmarrja e saj gjen mbështetje dhe në Ligjin Nr. 7928, date 27.04.1995, “Per Tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, neni 36, pika 1 i cili percakton se: *“1. Personi i tatueshem qe kryen furnizimin, eshte i detyruar te leshoje per personin qe merr **furnizimin** nje fature ne lidhje me ate furnizim, pervec rasteve qe ne kete ligj percaktohet ndryshe. 1/1 Ne fund te fatures shenohet bleresi me emer, mbiemer, nenshkrim, transportuesi me emer, mbiemer, nenshkrim dhe shitesi me emer, mbiemer, nenshkrim dhe vule...”*

Kolegji Administrativ i Apelit vlerëson se nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore rezultoi se mallrat e konfiskurara kanë qënë objekt i tenderimit zhvilluar nga pala paditëse me qëllim evadimin dhe shitjen e tyre kategorizuar skrap, pronë e saj.

Në momentin e kontrollit mallrat kanë qënë duke u transportuar për ne ambientet e shoqërisë fituese, ku sipas kushteve të kontratës malli do peshohej dhe do vlerësohej përfundimisht, me

qellim plotesimin e plote dhe te sakte te dokumentacionit per shitjen e skrapit. Në gjykim ka rezultuar se mallrat shoqëroheshin nga punonjësit e palës paditëse me fletë shoqërimi malli sipas procedurës së peshimit kryer në Degën e Doganës Berat dhe se fatura tatimore nuk ka patur të specifikuar peshën e tij.

Po ashtu, ka rezultuar se nga ana e inspektorëve të hetimit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, në vijim të veprimeve kanë kryer dhe peshimin e mallrave ne subjektin privat te licensuar, zoti Y. Bekaj ne Lushnje me qëllim verifikimin e peshes se mallit së pasqyruar në Flete-Peshoret e mallit qe ishin marre ne peshoren e Doganes se Beratit të paraqitura gjatë kontrollit nga pala paditëse. Nga ky verifikim nuk kanë rezultuar diferenca.

Në të tilla rrethana, Kolegji cmon se me të drejtë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka analizuar përgjegjësinë e palës paditëse në vështirim të përcaktimeve të Udhëzimit Nr.24, datë 2.9.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” ku rezultojnë kritere te tjera te cilat jane te domosdoshme per te sjelle si pasoje konfiskimin e mallit nga pala e paditur. Ne baze te ketij udhezimi te Ministrit te Financave, rezulton se per konfiskimin e mallrave nuk mjafton thjeshte fakti i mosshoqerimit te mallit me fatura tatimore shitje, por duhet qe ky veprim te kete si qellim ne vetvete shmangien e subjektit nga pagimi i detyrimeve tatimore, ose te pakten, duhet qe punonjesve te administrates tatimore tu krijohet nje bindje e tille.

Konkretisht në pikën 121.1 të këtij Udhëzimi “Mallrat e pashoqëruara me dokumente tatimore” gjendet shprehimisht rregullimi se:

“121.1 Tatimpaguesi, që mban në ruajtje, përdor ose transporton mallra të pashoqëruara me dokumentet e dhura tatimore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, dënohet me konfiskim të të gjithë sasisë së mallit, që mbahej në ruajtje, përdorej apo transportohej, i pashoqëruar me dokumente tatimore.

Për zbatimin e këtij dënimi punonjësit e administratës tatimore duhet të evidentojnë me saktësi faktin që mallrat janë pa dokumentet e kërkuar ligjorë dhe gjykojnë se këto mungesa kanë shkaktuar ose kanë për qëllim shmangien e tatimeve, duke pasur parasysh edhe dispozitat e pikës 58 të këtij Udhëzimi”.

Në gjykimin e cështjes, pyetjes nëse pala paditese ka vepruar me tendence per fshehje te ardhurash apo qellime abuzimi, sic shprehet udhezimi i Ministrise se Financave Nr. 24, datë 2.9.2008, përfaqësuesi i palës së paditur është shprehur se nuk kanë konkluduar për tendenca te tilla.

Dëshmitari Ilir Sado, me detyren e Drejtorit te Kontrollit Tatimor prane Drejtorise Rajonale Tatimore Berat ka sqaruar në gjykim se: “... Kemi bere rakordimin midis Ndermarrjes dhe Inspektoreve te Drejtorise Rajonale per procedurat dhe kemi vendosur te pajisim subjektin me NIPT-in sekondar dhe fature shoqerimi per shoqerimin e mallrave nga Kombinati drejt pikave ku kombinati ka marredhenie kontraktuale. Nga ky moment e me pas, subjekti operon me kete procedure. Mjeti shoqerohet vetem me flete shoqerimi, ndersa fatura tatimore plotesohet vetem ne momentin e peshimit ne destinacion. Kjo perben proceduren qe zbatojme”.

Pala paditëse rezulton të ketë vënë më parë në dijeni autoritetet tatimore dhe nuk rezultojnë asnjë rrethanë që bëjnë të besueshme veprime të palës paditëse te cilat synonin shmangien e

detyrimeve tatimore nga pala paditese, pasur parasysh edhe faktin se nuk kanë rezultuar diferenca mes peshes faktike dhe peshes se shenuar ne fleten e shoqerimit te mallit.

Ne te tilla rrethana, Kolegji cmon se drejt ka vleresuar gjykata e shkalles se pare se vlerësimet e organit tatimor janë të gabuara për shkak se pasaktësitë e gjetura në shoqërimin e mallit nga pala paditëse nuk mund të mbështesin ligjërisht dënimin për konfiskimin e mallrave.

Per sa me siper, duke vleresuar te pabazuara shkaqet e ngritura ne ankim, Kolegji Administrativ i Apelit konkludon se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier duhet të lihet në fuqi pasi vjen si rezultat i çmuarjes së drejtë të provave në përputhje me ligjin e zbatueshëm.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, mbështetur ne nenin 50, germa "b" te Ligjit nr. 49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative",

V E N D O S I

1. Lënien ne fuqi te vendimit Nr. 6204 (2140) date 06.11.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.
2. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet rekurs në Gjykatën e Larte brenda 30 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të tij.

U shpall në Tiranë, sot më 06.04.2016.

ANËTARE
Altina NASUFI
(D.V)

ANËTARE
Rilinda SELIMI
(D.V)

KRYESUES
Kastriot SELITA
(D.V)

E njesuar me origjinalin

Kancelari
Leonard Stekaj
Stekaj